



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHETIT

Tiranë, më 31.01.2019

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Zyrave të Avokaturës së Shtetit në nivel qendror
Zyrave të Avokaturës së Shtetit në nivel vendor

Në mbështetje të ligjit nr. 86/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, me Urdhrin nr. 178, datë 31.12.2018, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është miratuar Rregullorja “Për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit”, si dhe me Urdhrin nr. 179, datë 31.12.2018, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, është miratuar Programi “Për vlerësimin profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit”.

Në mbështetje të nenit 8 (Njoftimi dhe regjistrimi i kandidatëve), të Rregullores “Për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit”, njoftojmë se testimi me shkrim do të zhvillohet për të gjithë kandidatët ditën e **Hënë datë 11.03.2019, ora 09:00**. Kandidatët duhet të paraqiten në ambientet e zhvillimit të provimit me shkrim 30 minuta përpara orarit të fillimit të provimit me qëllim verifikimin e prezencës mbi bazë të dokumentit të identifikimit dhe sistemimin në pozicionin përkatës të provimit.

Në të njëjtën kohë, të gjithë punonjësit e Avokaturës së Shtetit në të dy nivelet, të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit, të cilët do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit profesional për marrjen e titullit “Avokat Shteti”, duhet të paraqesin brenda datës **15.02.2019**, pranë Sektorit të Protokoll-Arkivit, të Avokaturës së Shtetit (Zyra Qendrore), kërkesën sipas formatit bashkëlidhur të këtij njoftimi. Kandidati do të pajiset me një vërtetim për kërkesën e dorëzuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!